



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
industry

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E TREGTISE DHE INDUSTRIJE-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE	
Numri Orig. Llogaritja Kyç	03/2015
NKPRIC Sh. PROL Prenje	1511
Datë Duke	29.09.16

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën :

REKRUTIM

Institucioni:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve

Titulli i vendit të punës:

Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike

Koeficienti / 8.5

Nr. i Referencës: MTI/23

Datë: 29.09.2016

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planin vjetor për zhvillimin e zonave ekonomike, inspekton dhe monitoron programin e punës së zonave ekonomike dhe dorëzon raportet periodike.
- Identifikon zonat ekonomike potenciale për zhvillim dhe në bashkëpunim me komunat përgatit procedurat për krijimin dhe ndërtimin e tyre.
- Pranon, shqyrton dhe vlerëson aplikimet për krijimin e zonave ekonomike, verifikon që janë në përputhshmëri me legjislacionin ekzistues dhe procedon rekomandimin për vendimin final tek Drejtori për ZhSP.
- Mban kontakte dhe koordinon punët e Agjencisë (KIESA) për zhvillimin e zonave ekonomike me zhvilluesit (publik apo privat) e zonave ekonomike dhe me institucionet tjera përkatëse.
- Negocion dhe zgjidh çështjet që lidhen me zhvillimin dhe punën e zonave ekonomike, si dhe merr përsipër përgjegjësitë menaxheriale për të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e zhvillimit të zonës ekonomike,
- Në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtoratit për ZhSP planifikon dhe monitoron buxhetin e zonave ekonomike dhe ndërmerr veprime korrigjuese sipas nevojës dhe kërkesave.
- Mbanë evidencë të zonave ekonomike, përfshirë gjendjen infrastrukturore, si dhe informatat për bizneset që janë brenda zonave ekonomike.
- Kryen detyra të tjera sipas nevojës për të realizuar misionin, qëllimet, objektivat, aktivitetet dhe detyrat e Sektorit, Drejtoratit dhe të Agjencisë dhe/ose sipas kërkesave të Drejtorit të Drejtoratit të ZhSP-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

Diploma universitare: Fakulteti i ndërtimtarisë, Ekonomik.

Së paku katër (4) vite përvojë pune;

Të ketë aftësi në organizim, menaxhim, komunikim dhe në përcaktimin e prioritetëve të punëve;

Gatishmëri për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe me pak mbikëqyrje;

Të njohë MS Office dhe internetin;

Gjuha angleze e perferuar.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

13.10.2016

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **13.10.2016**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak te numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.